



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas

Zyra e Kryetarit

Nr. 031-374 më 06.01.2015



Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Nexhat Demaku

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 29.12.2014

1. Vendimi për aprovimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2015-2019 të Komunës së Drenasit
2. Vendimi për ndryshimin e Rregullorës Komunale për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba

Drenas

Më datë: 06.01.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit (Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-400-285 dt. 06.01 2015

Bazuar në nenin 12.1 dhe nenit 40 të Ligjit për Vetqeverisjen lokale Nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 e Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën 29.12.2014 miraton këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2015-2019

TË KOMUNËS SË DRENASIT

Neni 1

Me këtë Vendim aprovohet Strategjia e zhvillimit Ekonomik Lokal 2015-2019.

Neni 2


Për implementimin e kësajë strategjie do të kujdesen të gjitha Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryesuesi I Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendit i Komunës



Nr. 12-400-281 dt 06.01.2015

Bazuar në nenin 12.1 dhe 12.2 pika c dhe nenit 40 të Ligjit për Vetqeverisjen lokale Nr.03/L-040 nenit 34 pika 34.6 e Statutit të Komunës së Drenasit ,Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën 29.12.2014 miraton këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORËS KOMUNALE PËR TAKSA,TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja komunale për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoba. Nr. 12-031-14046 Dt. 04.04.2014

Neni 2

Për zbatimin e kësajë Rregullorës do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorati i Inspektoratit Komunal.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. 400-293 dt. 06.01, 2015

NDRYSHIMI DHE PLOTSIMI I
RREGULLORËS KOMUNALE
PËR
TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

Drenas,
Dhjetor 2014

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika c dhe nenit 40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 nenit 2.3 të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e Pushtetit Lokal , nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit ,KUVENDI I i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën : 29.12.2014 miratoj :

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS KOMUNALE PËR

TAKSA, TARIFA ,NGARKESA DHE GJOBA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e tarifave dhe ngarkesave për shërbime nga veprimtaritë , që do të paguajnë personat fizik dhe juridik në emër të: shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike ,përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare,ushtrimin e veprimtarisë biznesore, pelqimeve për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, për shërbime profesionale, pronësisë së automjeteve motorike, përdorimin apo shfrytëzimin e pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrave nga qiradhënia, gjobat komunale-gjoba nga trafiku, dhe gjobat për shkeljen e rregullorëve Komunale.

II.LARTËSIA E TAKSAVE KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TERITORIN E KOMUNËS SË DRENASIT

Neni 2

Lartësia e ngarkesave ngarkesave që do të paguajnë personat fizik dhe juridik në emër të shërbimeve apo veprimtarive Komunale,do të jenë si vijon:

Neni 3. Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste-
Biznesore në territorin e Komunës së Drenasit.

3.1. Ngarkesat vjetore Komunale		Taksa Aktuale
Veprimtaria		
Metalurgjia e rëndë-Shkritoret		60.000,00 €
Minierat		10.000,00 €
Gurëthyesit		3.000,00 €
Postat ,shërbimet postare		800,00 €
Bankat		1.200,00 €
Trafot kryesore-Shpërndars të energjisë elektrike		2.000,00 €
Kompanit e sigurimeve që merren me sigurimin e automjeteve,pasurisë,përsonave etj.		800,00 €
Bastoret		800,00 €
Pompat e derivateve në rrugë magjirtrale dhe regjionale		1.200,00 €
Pompat për derivate në rrugë lokale		200,00 €
SH.P.K. të tjera e që nuk janë të përfshira		250,00 €
N.T.P.-N.N.-NSH-.NH, përpunuse si dhe të gjitha tipet e nderrmarrjeve		200,00 €
Nderrmarrjet sherbyse prej ma të ndryshmeve		200,00 €

.Kulturat e drithërave,perimeve hortikultura dhe mullinjët	-
.Blegtoria	-
.Kulturat bujqësore,rritja e bagëtive,shpendëve dhe kafshëve tjera.	-
.Veprimtaritë shërbyese veterinere.	200,00 €
.Prodhimi i veshjeve me lekure	150,00 €
.Prodhimi i këpucëve dhe mbathjeve tjera	150,00 €
Prodhimi i zduktarisë dhe elementeve tjera(Dyer,dritare tj)	150,00 €
.Prodhimi i produkteve tjera prej letre,kartuçi.	150,00 €
Prodhimi i lëndëve plastike	150,00 €
.Prodhimi i produkteve tjera kimike	150,00 €

3.2. Veprimtarit tjera		
Ordinancat Shëndetsore		250,00 €
Barnatoret		250,00 €
Kontrollime teknike		500,00 €
Shpërndarës të internetit dhe TV kabllorë		1.000,00 €
Avokaturat		200,00 €
Noteri		200,00 €
Lojrat e fatit, automatët dhe klubet e veqanta (klubet e natës)		1.000,00 €
Ekspluatimi –grumbullimi i rëres për qellime komerciale		1.000,00 €
Veprimtaria e Qerdheve		150,00 €
Agjensit e ndërmjetsimit në transaksionet e pasurisë së patundshme dhe agjensionet tjera.		200,00 €
Veprimtarit e Shtypshkronjave dhe aktiviteteve grafike		200,00 €
Tregtija e Automjeteve të reja		500,00 €
Tregtia e Automjeteve të vjetra dhe autopjesë të vjetra		250,00 €
3.3. Njësit e ndërmarrjeve që e ushtrojnë veprimtarinë në teritorin e Komunës paguajnë 30% të tarifës bazë (në rastet që edhe selia është në teritorin e Komunës së Drenasit)		
3.4. Bizneset të cilat licencohen nga Ministrinë përkatëse, paguajnë taksën Komunale e cila shërben si provë për licencim		
3.5. Tregëtia me shumicë e artikujve ushqimor lirohet 30% në zonat rurale të Komunës së Drenasit.		

3.6.

1. Të gjitha Biznesët fillestare të regjistruara nga viti 2013 vazhdojnë të lirohën nga pagesa e Taksës Komunale per 1 vitë kalendarik.
2. Të gjitha Biznesët prodhuese fillestare të regjistruara nga viti 2013 vazhdojnë të lirohën nga Taksa Komunale për 3 vite.
3. Biznesët fillestare të cilat punësojnë mbi 10 punëtorë lirohën nga taksa Komunale për 5 vite duke filluar nga viti 2014.
4. Duke filluar nga viti fiskal 2013 vazhdojnë të lirohën për kohë të pacaktuar nga pagesa e Taksës Komunale të gjitha Biznesët ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në të gjitha sektorët e prodhimtarisë Bujqesore.
5. Të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtari me pakicë (DPZ, DPT,DPSH,DPH ,Taksi sherbimet etj.) nga viti 2014 lirohën nga taksa Komunale për kohë të pacaktuar .
6. Të gjitha bizneset që raportojnë në ATK , me pasqyrëza financiare (formular) të pagesës së tatimit në qarkullim e të cilët dorzohën për atë vitë kalendarik me zero qarkullim lirohën edhe nga taksa Komunale për atë vitë kalendarik që nuk kanë ushtruar veprimtarinë duke i sjellur si dëshmi pasqyrzat financiare të vertetuara nga ATK-ja.
7. Inspektorati Komunal me qëllim të evitimit të parregullsive të tregtisë joformale duhet ti verifikojnë Qertifikatat e regjistrimit të bizneseve dhe të konstatojnë se a zhvillojnë aktivitet të njëjtë me shifrat e kodeve të veprimtarisë së regjistruar.

3.7. MASAT NDËSHKUESE.

- I. Kjo Rregullore dhe rregulloret tjera Komunale të miratuara nga Kuvendi i Komunes së Glllogocit, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e tyre.
- II. Lartësitë e gjobave janë të bazuara në disproporcion me shkeljet e dispozitave të Rregulloreve Komunale.
- III. Të gjitha subjektet të cilat nuk i përgjigjën pagesës së tarifave dhe ngarkesave Komunale të parapara me këtë Rregullore do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm nëpërmes të Organit përmbarus kompetent ndërsa dispozitat tjera të kësaj Rregullore mbeten të pandryshuara

Neni IV

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, kurse zbatimi i sajë do të bëhet nga DBZHE dhe DI të Komunës së Drenasit.



KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS


NAIM BAZAJ